HandiKOS Kaçanik

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARANË KOMUNËN E KAÇANIKUT 2019-2021

KAÇANIK, 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e: *Shoqata e personave me aftesi te kufizuara/Handikos-Kaçanik (SH.P.A.K-HK)* dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrimi SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

# Përmbajtja


Falënderimet....4

Akronimet dhe Shkurtesat....5

Hyrje....6

Qëllimi....7

Objektivat....7

Metodologjia....9

**Shëndetësia**

***Objektiva strategjike:*** *Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara*....11

**Mirëqenia sociale**

***Objektiva Strategjike*:** *Sistem funskional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale* të personave me aftësi të kufizuara....15

**Punësimi**

***Objektiva Strategjike:*** *Ofrimi i mundësive të barabarta për aftësim dhe punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara*....*18*

**Arsimi**

***Objektiva strategjike:*** *Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara*....*23*

**Qasja, Informimi, Komunikimi dhe Statistika**

***Objektiva strategjike:*** *Krijimi i kushteve të barabarta në qasje,informim komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar të të dhënave për Persona me Aftësi të Kufizuara*....*26*

## *Falënderimet*

Dokumente të tilla nuk mund të jenë meritë e vetëm një autori, institucioni ose organizate, prandaj edhe puna dhe merita në hartimin e këtij dokumenti të quajtur “Plani Lokal i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2019-2021” i’u atribuohet shumë përfaqësuesve të komuniteteteve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme të cilët treguan konstruktivitet dhe përkushtim në hartimin e këtij plani.

Mirënjohje të thellë për të gjithë palët e përfshira në procesin e konsultimeve në hartimin e këtij plani. Në rend të parë një falënderim të përzemërt për personat me aftësi të kufizuara që në vazhdimësi kanë qenë të gatshëm dhe konstruktiv për të ndarë me ne përvojat dhe sfidat e tyre me të cilët ata përballen ç’do ditë. Falëndërojm prindërit, familjarët e personave me aftësi të kufizuara të cilët ndanë me ne përvojat e tyre të kujdesit ditor për familjarët e tyre, persona me aftësi të kufizuara. Falënderime për institucionet komunale-Kaçanik si asamblenë komunale, ekzekutivin komunal, Qendrën për Punë Sociale, Zyren e Punësimit, Qendrën e Mjekësisë Familjare. Falënderojm për pjesmarrje aktive dhe konstruktive të gjitha subjektet politike si dhe organizatat e shoqërisë civile të cilët kan qenë pjesë e vazhdueshme e konsulencës në ndërtimin e këtij Plani Lokal të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

S’do të mund të fillonim dhe përfundonim një projekt të tillë pa përkrahjen nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) si dhe donatorëve, Agjencia Zvicerrane për Zhvillim e Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Jashtme Daneze (Danida), ndaj të cilëve jemi falënderues në mënyrë të veçant.

## AKRONIMET DHE SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **AK-** | Aftësia e Kufizuar |
| **DAK-** | Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës |
| **DFEZH-** | Drejtoria e Financave Ekonomis dhe Zhvillimit |
| **DUKM –** | Drejtoria e Urbanizmit Kadastrës dhe Mjedisit |
| **DSHMS** | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| **DSHPEC-** | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile |
| **HANDIKOS -** | Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara -Kaçanik |
| **OPAK-** | Organizata të Personave me Aftësi të Kufizuara |
| **OJQ-** | Orgaznizata Joqeveritare |
| **PAK -** | Personat me Aftësi të Kufizuara |
| **PNVPAK-** | Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara |
| **PLVPAK -** | Plani Lokal i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara |
| **QAP-** | Qendra e Aftësimit Profesional |
| **QPS -** | Qendra për Punë Sociale |
| **QKMF -** | Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare |
| **SNDPAK-** | Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara |
| **SHMP-** | Shkolla e Mesme Profesionale |
| **ZDNJ-** | Zyra e të Drejtave të Njeriut-Kaçanik |
| **ZP-** | Zyra e Punësimit |

## *Hyrje*

Prej izolimit social ose "larg syve të botës" e deri tek niveli aktual i integrimit social çështja e aftësisë së kufizuar ka qenë pjesë tematike e të gjitha civilizimeve botërore. Mirpo, sot në botën bashkëkohore përpos përceptimit pozitiv dhe mendimit më pro integrimit të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale, çështja e aftësisë së kufizuar ka kaluar jo thjeshtë vetëm në vullnetin e shoqërisë por edhe në krijimin e normave dhe mekanzimave juridik të cilat paracaktojn të drejtat dhe detyrimet ndaj çështjesë së aftësisë së kufizuar për shtetet , shoqëri dhe individ në cilën do pjesë të botës bashkëkohore.

Statistikat botërore na flasin që numri i personave me aftësi të kufizuara është në miliona (afër 10% e popullësisë së botës ka një aftësi të kufizuar) prandaj, shtete të ndryshme kan krijuar masa dhe veprime përmes politikave të ndryshme për përkujdesjen dhe integrimin e tyre social.

Sipas të dhënave të Handikos-Kaçanik, në komunën e Kaçanikut numri i personave me aftësi të kufizuara nga të gjitha kategorit aktualisht është rreth 400 persona. Prandaj, kërkesat, nevojat dhe sfidat e tyre jan nga më të ndryshme, që nga përkujdesja ditore ndaj tyre e deri tek ekzistenca e barrierrave të ndryshme shoqërore dhe institucionale për integrimin e tyre social në përgjithësi.

Si përgjigje ndaj kësaj dhe duke parë edhe mungesën e një plani për qasje më koherente dhe gjithpërfshirëse ndaj çështjës së aftësisë së kufizuar në komunën e Kaçanikut, organizata jonë Handikos në përkrahje me donatorë të ndryshëm ka filluar projektin e qujatur "Përfshirja e çështjës së aftësisë së kufizuar në politikat lokale", rezultat konkret i të cilit është ky dokument i quajtur "Plani Lokal i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021". Ky dokument i cili i'u është nënshtruar diskutimeve dhe konsulencave të vazhdueshme me institucionet komunale, shoqërinë civile, partitë politike por edhe komunitetin e personave me aftësi të kufizuara ka për synim që në një afat tre vjeqar të arrihet të përmirësohet jeta e përditëshme e personave me aftësi të kufizuara në disa nga fushat e specifikuara në këtë plan, por edhe të i'u qasemi më seriozisht integrimit të tyre social e publik në komunën tonë.

Ky dokument do i'u dërzohet autoriteteve komunale për miratim në mënyrë që të shërben si dokument orientues (plan pune) në periudhën 2019-2021 ndaj çështjesë së aftësisë së kufizuar në Kaçanik.

## *Qëllimi*

Si një nga komunitetet më të margjinalizuara të formacioneve shoqërore jo vetëm në vendin tonë, por edhe në pjesë tjera të botës bashkëkohore cilësohen komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Ky dokument unik ka për qëllim trajtimin sistematik institucional por edhe shoqëror të çështjesë së aftësisë së kufizuar në komunën e Kaçanikut për gjatë periudhës tre vjeqare 2019-2021. Përmes këtij plani synohet që të përmirësohet gjendja e përgjithëshme e personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë, me fokus të veçant në gjithëpërfshirje dhe përmirësim të cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara përmes plotësimit të të drejtave dhe nevojave të tyre në fusha të tilla si shendetësia, punësimi, mirëqenia sociale, arsimi dhe qasja në jetën kulturore politike e sociale në përgjithësi.

Gjithashtu ky dokument do të sherben edhe si dokument orientues për komunën e Kaçanikut që të njoh më mirë nevojat e komuntetit të personave me aftësi të kufizuar, por edhe në harmoni me këtë dokument të orienton politikat dhe aktivitetet e saj për të siguruar gjithëpërfshirje dhe integrim në jetën sociale në përgjithësi të personave me aftësi të kufizuar në komunën e Kaçanikut. Përfshirja e çështjesë së aftësisë së kufizuar në politikat lokale(si ky dokument i quajtur Plan Lokal Veprimi për Personat me Aftësi të Kufizuara) ka për qëllim edhe mundësin që institucionet komunale të komunës së Kaçanikut çështjes së aftësisë së kufizuar të i'u qasen në mënyrë sistematike përmes një "plani pune" e jo "*ad hoc*" në raste dhe për raste të veqanta.

Në përgjithësi dhe në veqanti në komunën tonë qëllimi i këtij plani është krijimi i mundësisë së një *"shoqërie gjithpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin e plotë të tyre dhe jetojnë jetë të dinjitetshme si qytetarë të barabartë" në komunën e Kaçaniku.*

## Objektivat

Ky plan i veprimit përcakton politikat dhe veprimet e institucioneve lokale ndaj prioriteteve të çështjes së aftësisë së kufizuar në disa nga fushat prioritare të përcaktuara nga diskutimet, punëtorit dhe tryezat e ndryshme me akterë të ndryshëm. Në funksion të këtyre fushave ky plan i veprimit si synim ka arritjen e këtyre objektivave strategjike, të cilat objektiva janë të shoqëruara edhe me objektiva tjera specifike ku janë të përcaktuara aktivitetet, treguesit, mjetet e verifikimit, synimet e secilit aktivitet, afatin kohor të realizimit si dhe koston financiare të përllogaritur për secilin aktivitet.

***Objektiva strategjike 1:*** *Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara*

***Objektiva strategjike 2 :*** *Sistem funskional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale.*
***Objektiva strategjike 3:*** *Ofrimi i mundësive të barabarta për aftësim dhe punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.*

***Objektiva strategjike 4:*** *Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.*

***Objektiva strategjike 5:*** *Krijimi i kushteve të barabarta në qasje,informim ,komunikim,pjesëmarrje si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar të të dhënave për Persona me Aftësi të Kufizuara.*

## Metodologjia

Ky dokument i'u është nënshtruar përgjithësisht rregullave standarte për hartimin e dokumenteve të tilla strategjike. Përdorimi i dokumeteve referuese ndërkombëtare dhe kombëtare është shfrytëzuar për ndërtimin e bazamentit teorik dhe thellimin e njohurive mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, por edhe krijimin e bazës legale referente të këtij dokumenti. Përpos kuadrit ligjor ndërkombëtar e kombëtar rëndësi të veçantë i'u është kushtuar edhe studimit të kornizës së mekanizmave institucionale vendore mbi çështjen e aftësisë së kufizuar.

Dokument kryesor referues ky Plan i Veprimit ka pasur *Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023(*SNDPAK) si dhe dokumentin *Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2017-2019(*PNVPAK), duke ndjekur qasjen krahasuese ndermjet objektivave të SNDPAK-së dhe PNVPAK-së mundësive të inkorporimit dhe përshtatshmërisë së tyre tek PLV për PAK në komunën tonë. Gjithashtu janë konsultuar disa nga dokumentet të tilla si Plane Lokale të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara të karakterit lokal të disave nga komunat e Republikës së Kosovës si edhe dokumente tjera relevante të çështjes së aftësisë së kufizuar.

Konsulencat përmesë të quajturave "punëtori" kan shërbyer si pjesë e punës në hartimin e këtij dokumenti. Një(1) punëtori e tillë është realizuar me personat me aftësi të kufizuara. Në këtë punëtori janë identifikuar nevojat dhe prioritetet e personave me aftësi të kufizuara drejtëpërsëdrejti nga personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

Një tjetër punëtori është zhvilluar edhe me përfaqësuesit e drejtorive komunale në të cilën janë njoftuar me nevojat dhe prioritetet e PAK-ve të identifikuar në punëtorinë me PAK-të. Përmesë kësaj punëtorie është arritur të përcaktohen aktivitet, kapacitetet njerëzore, kostot finanaciare korniza kohore e realizimit të këtyre aktiviteteve në PLV-në për PAK-ët.

Takimet kanë qenë një tjetër mënyrë e realizimit të projektit. Një numër prej 19 takimesh janë realizuar në distanca të ndryshme kohore si para gjatë dhe në fund të projektit. Pjesë e këtyre takimeve kanë qenë kategorit e ndryshme të komuntetit të personave me aftësi të kufizuara, bartës dhe përfaqësues të institucioneve lokale si legjislativi dhe ekzekutivi, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të organziatave joqeveritare dhe institucionet tjera relevante .

Tryeza kan shërbyer si njëra nga qasjet në draftimin e këtij dokumenti ku përmes diskutimeve dhe kritikave të ndryshme ndërmjet akterëve të ndryshëm, përfituesve direkt dhe indirekt të projektit është arritur që të finalizohen masat dhe veprimet e akterëve zbatues të projektit.

Vizitat me karakter informues në komunat fqinje si në institucione ashtu edhe në organizatat që merren me personat me aftësi të kufizuara, si pjesë e marrjesë së praktikave të mira ka qenë njëra nga mënyrat e hartimit të këtij dokumenti.

## SHËNDETËSIA

***Objektiva Strategjike 1 :***Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

| *Objektiva specifike 1: Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore* | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Treguesit** | **Mjetet e verifikimit** | **Synimi** | **Institucion i zbatues** | **Institucion i mbështetës** | **Afati Kohor** | | | **Buxheti** |
| | | | | | | **V1** | **V2** | **V3** | |
| 1.1. Analiza e gjendjes shëndetësore dhe nevojat për kujdes shëndetësor për PAK. | 1.Formimi i komisionit për mbledhjen e të dhënave.<br>2.Mbledhja e të dhënave.<br>3.Analiza e realizuar e të dhënave. | Raporti me të dhënat e analizuara. | Verifikimi i nevojave për kujdesin shëndetësor të PAK. | DSHMS | HandiKos | x | | | Pa kosto |
| 1.2. Trajnimet e ekipeve mjekësore dhe infermiereve që ofrojnë sherbime shëndetësore për PAK. | 1.Vendosja në korrikulat e trajnimeve të stafit mjekësor çështjën e sherbimeve shendetesore të PAK.<br>2.Numri i planifikuar i trajnimeve. | 1.Numri i trajnimeve të realizuara.<br>2.Numri i profesionistëve mjekësor të trajnuar në sektorin shëndetësor | Ngritja e kapaciteteve të stafit mjekësor për kujdes shëndëtësor të PAK. | DSHMS<br>QKMF | MSH<br>HandiKos<br>Donatorë të tjerë. | x | x | x | 1000 € |
| 1.3. Trajnimi i personelit shendetësor në përdorimin e gjuhës së shenjave (interpret të gjuhës së shenjave). | 1.Plani i trajnimit periodik për vitin e parë dhe të dytë.<br>2.Përzgjedhja e personelit për trajnim. | Numri i stafit të trajnuar për interpret. të gjuhës së shenjave | Ngritja e kapaciteteve të stafit mjekësor në përdorimin e gjuhës së shenjave. | DSHMS<br>QKMF | HandiKos<br>Donatorët | x | x | | 1500 € |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4. **Krijimi** i databazës për të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara. | 1.Formimi i ekipës për mbledhjen e të dhënave/ diagnozav të të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuara.<br>2.Futja e të dhënave në sistemin e databazës. | Numri i Personave me Aftësi të Kufizuara të evidentuar në databazë. | Pasqyrimi unik i numërit të Personave me Aftësi të Kufizuara. dhe diagnozat e tyre. | Handikos | DSHMS<br>QPS | x | | | Pa kosto |

| *Objektivi Specifik 2: Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK dhe ndergjegjësimi i komunitetit në fushën e PAK-ve* | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Treguesi** | **Mjetet e verifikimit** | **Synimi** | **Institucion i zbatues** | **Institucioni mbështetës** | **Afati kohor** | | | **Buxheti** |
| | | | | | | **V 1** | **V 2** | **V 3** | |
| 2.1. Hulutmimi i nevojave mbi plotësimin e listës esenciale të barnave për PAK dhe furnizimi i tyre. | Hulumtimi i realizuar mbi këto nevoja. | Të dhënat e hulumtimit të realizuar. | Harmonizimi i nevojave të PAK në listën esenciale të barnave. | DSHMS<br>QKMF | HandiKos | x | x | x | Pa kosto |
| 2.2.Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të nevojshme për PAK me inkonitinencë dhe materialeve për plagë dekubitare. | 1.Numri i personave që kanë nevojë për këto materiale.<br>2. Numri i materialeve të ofruara. | Lista e personave të evidentuar të cilët kan pranuar këto materiale. | Lehtesimi i sherbimeve dhe ofrimi i paisjeve ndihmëse shëndetësore për PAK. | DSHMS<br>QKMF | MSH<br>Donatorët<br>HandiKos | x | x | x | 3000 € |
| 2.3. Ofrimi i sherbimeve mjekësore mobile në teren. | 1.Caktimi i numrit të punëtoreve shëndetësor.<br>2.Lloji i sherbimeve te ofruara/nevojshme për PAK. | 1.Vizitat shtepiake.<br>2.Numri i sherbimeve të pranuara. | Përimirësimi i sherbimeve shëndëtësore të PAK. | QKMF | HandiKos | x | x | x | 1500 € |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4. Hartimi dhe zbatimi i programit për edukim shëndetësor dhe i pakos informuese për prindër në zbulimin e hershëm të shkakëtarëve që rezultojnë në AK. | 1.Programi i hartuar.<br>2.Numri i trajnimeve të realizuara.<br>3.Numri i prinderve të trajnuar.<br>4.Numri i fletushkave/broshurave informuese. | 1.Zbatimi i programit.<br>2.Lista e pjesëmarrëseve<br>3.Fletushkat/broshurat informuese. | Vetëdijësimi dhe edukimi i prinderve në njohjen e shkaktarëve që rezultojn në AK. | Handikos | DSHMS<br>QKMF | x | x | x | 1000 € |
| 2.5. Informimi i PAK dhe i familjareve të tyre për kujdesin shëndëtësor përmes trajnimeve. | 1.Numri i i materialeve të shpërndara/fletushka, broshura me Brail).<br>2.Numri i trajnimeve të organizuara. | 1.Materialet e publikuara.<br>2.Trajnimet e realizuara. | Vetëdijësimi i familjareve për kujdes shëndëtësor të PAK. | DSHMS<br>QKMF | HandiKos | x | x | x | 1000 € |
| 2.6. Vetdijësimi i komunitetit të PAK për vaksinim. | 1.Organizimi i aktiviteteve vetdijesuese në vendbanimet urbane<br>2.Organizmi i aktiviteteve vetdijesuese në vendbanimet rurale | 1.Numri i fushatave sensibiluzuese për vaksinim.<br>2.Numri i materialeve të shperndara/fletushka/broshura. | Kujdesi shendetesor për PAK. | Handikos | DSHMS | x | x | x | 2000 € |
| 2.7. Vaksinimi i PAK. | Vaksinimi i PAK. | 1.Numri i të vaksinuareve. | Kujdesi shendetesor për PAK. | QKMF | HandiKos | x | x | x | Pa kosto. |

## MIRËQENIA SOCIALE

*Objektiva Strategjike 2:* Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale.

**Objektivi specifik 1:** *Shtrirja e shërbimeve në komunitet dhe mirëqenia sociale e PAK-ve*

| Aktiviteti | Treguesit | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucioni mbështetës | Afati Kohor | | | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | V 1 | V 2 | V 3 | |
| 1.1. Fuqizimi i ofrimit të shërbimeve sociale për PAK dhe familjet e tyre | 1.Numri i personave që kanë nevojë për shërbime sociale.<br>2.Numri i personave që kanë përfituar nga shërbimet sociale. | Raportet vjetore. | Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve sociale për PAK. | DSHMS<br>QPS<br>MPMS | HandiKos | x | x | x | 10.000€ |
| 1.2 .Rregullimi/ndertimi i një qendre ditore për PAK. | 1.Hartimi i projektit.<br>2.Sigurimi i lokacionit për ndërtimin e qendrës ditore. | Funksionalizimi i qendrës ditore. | Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve për PAK. | Komuna | MPMS<br>Donatorë<br>HandiKos | x | x | x | 180.000€[1] |
| 1.3 .Këshillime Profesionale për Nevojat e PAK dhe familjarëve të tyre. | 1.Zyra e të drejtave të njeriut. | Numri i këshiillimeve. | Ofrimi i këshillimeve profesionale në fusha të ndryshme , ligjore ekonomike, sociale etj. | QPS<br>ZDNJ | HandiKos | x | x | x | Pa kosto |
| 1.4. Ofrimi i sherbimeve për transportin e komuntetit të PAK. | Sigurimi i një automjeti(minibus) me specifikatë pershtatshme për PAK. | Sigurimi i automjetit . | Bartja e Personave me Aftësi të Kufizuara për aktivitete të ndryshme . | Komuna<br>Donatorët | HandiKos | x | | | 10.000€ |

[1] Ky çmim eshte perllogaritur në bazë të kostos së ndertimit të qendrës ditore në qytetin e Gjakovës e ndertuar në vitin 2018

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5.Ofrimi i mjeteve ndihmëse për lëvizje të PAK(karroca,kukëza,shetit ore,karroca tualeti,shtretër antidekubitar etj). | Numri i mjeteve lëvizëse të nevojshme për PAK. | Mjetet për lëvizje të siguruara për të gjitha kategoritë e PAK. | Përmirësimi i lëvizjes së PAK me mjete të nevojshme për lëvizje. | Komuna<br>Donatorët | HandiKos | x | x | x | E pa percakt uar. |
| 1.6. Themelimi dhe funksionalizimi i Komitetit Konsultativ. | 1.Vendimi per themelim te komitetit Konsultativ për PAK nga Kuvendi i Komunës Kaçanik.<br>2.Shpallja e konkursit per rekrutim. | Funksionalizimi i komitetit konsultativ të PAK. | Përfshirja e çështjes së AK në institucionet komunale. | Kuvendi Komunal | | X | X | X | 2400€ |

# PUNËSIMI

**Objektiva Srategjike 3:** *Ofrimi i mundësive të barabarta për aftësim dhe punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.*

| *Objektivi specifik 1: Krijimi i kushteve të barabarta për Punësimin e PAK-ve* | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Treguesi** | **Mjetet e verifikimit** | **Synimi** | **Institucioni zbatues** | **Institucioni mbështetës** | **Afati kohor** | | | **Buxheti** |
| | | | | | | **V 1** | **V 2** | **V 3** | |
| 1.1. Permbushja e kuotës së punësimit 50/1 për PAK në sektorin publik . | 1.Hapja e konkurseve të veqanta për Persona me Aftësi të Kufizuara.<br>2.Prioritizimi i punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara në të gjithë sektorët publik të komunës. | Punësimi i PAK-ve në sektorin publik për të përmbushur kuotën e punesimit të obliguar sipas dispozitave të ligjit Për Aftësim dhe Riaftësim Profesioanal dhe Punësim të PAK-ve | 1.Zbatimi i plotë i dispozitave të ligjit Për Aftësim dhe Riaftësim Profesioanal dhe Punësim të PAK-ve<br>2.Perfshirja e PAK-ve në tregun e punës në sektorin publik | Komuna | Inspektoriati i punës. | x | x | x | Në bazë të koeficie ntit të pagës së zyrtarit përcaka ktohet buxheti për këtë aktivitet |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 Hulumtimi i statistikave të punësimit të PAK-ve dhe niveli i përmbushjes së kuotës së punësimit 50/1 për PAK në sektorin privat. | 1. Të gjeturat e terenit lidhur me numrin e të punësuarve në sektorin privat<br>2.Të gjeturat e kompanive, bizneseve të cilat duhet të rrespektoj kuoten e punësimit 50/1 | Raporti me të dhenat e gjendjes së të punësuarve dhe kompanit të obiguara për permbushjen e kuotës 50/1. | 1.Zbatimi i plotë i dispozitave të ligjit Për Aftësim dhe Riaftësim Profesioanal dhe Punësim të PAK-ve<br>2.Perfshirja e PAK-ve në tregun e punës në sektorin privat | Komuna | Inspektoriati i punës. | x | x | x | 1500€ |
| 1.3. Krijimi i ndërmarrjeve sociale. | 1.Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale<br>2.Krijimi i vendeve të punës për PAK | Numeri i të punësuareve. | Vlerësimi i kapaciteve të të papunëve nga PAK dhe mbështetja institucionale për rritjen e punësimit për këtë komunitet. | Komuna | HandiKos | x | | | E papërca ktuar. |
| 1.4.Vetëpunësimi i PAK përmes granteve komunale. | Numri i granteve të dhëna nga institucionet komunale (së paku 3). | Numri i të punësuarve përmes këtyre granteve. | Rritja e numrit të të punësuarve të PAK. | Komuna | Donatorët | x | x | x | E paperca ktuar. |
| 1.5. Vetëpunësimi i PAK përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. | Numri i i granteve të përfituar nga kategoria e PAK. | Numri i të punësuarve përmes këtyre granteve. | Zvoglimi i numrit të të papunëve të PAK. | Organizatat vendore dhe nërkombëtare. | Komuna<br>Zyra ePunësimit | x | x | x | E pa percakt uar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.6.Fushata vetëdijësuese për punësimin PAK në sektorin privat. | Numri i fushatave të organizuara. | Takimet e realizuara. | Informimi i kompanive private në lidhje me rënësinë/përfitimet nga punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara. | HandiKos | Komuna | x | x | x | Pa kosto |
| 1.7.Punësimi i PAK në kompanit private. | 1.Takimet e institucioneve komunale me kompanit private.<br>2.Veprime konkrete nga kompanit private për punësimin e PAK. | Punësimi i 10 personave me AK | Përfshirja e PAK-ve në tregun e punës në sektorin privat | Kompanit/biz neset private. | Zyra e Punësimit<br>Donatorët | x | x | x | 100000 € |
| 1.8.Ndergjegjësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe familjareve të tyre për punësim dhe aftësim profesional. | Numri i takimeve informuese të organizuara me PAK dhe familjarët e tyre ( 2 takime në vit ). | Takimet e realizuara. | Informimi rreth mundësive për punësim për Persona me Aftësi të Kufizuaradhe mbështetja për familjet e tyre. | HandiKos | Komuna<br>Zyra e Punësimit | x | x | x | Pa kosto |

| *Objektivi specifik 2 : Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin Personave me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik* | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Treguesi** | **Mjetet e verifikimit** | **Synimi** | **Institucioni zbatues** | **Institucioni mbështetës** | **Afati kohor** | | | **Buxheti** |
| | | | | | | **V 1** | **V 2** | **V 3** | |
| 2.1 Hulumtimi i tregut të punës mbi mundësin e punësimit të PAK. | Analiza e situates ne terren nepermjet keshilltareve te punesimit. | Raporti i analizës së tregut të punës. | Hartimi i politikave për aftësim të PAK në raport me oferten e tregut të punës. | Komuna<br><br>Zyra e Punesimit | HandiKos<br><br>MPMS | x | x | x | Pa kosto |
| 2.2. Identifikimi dhe zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës në komunën e Kacanikut. | Numri i profileve të përshtatshme për PAK. | Programet e hartuara.<br><br>Profilet e akredituara.<br><br>Lista e PAK që janë certifikuar. | Ngritja e kapaciteteve profesionale të PAK. | Komuna<br><br>Zyra e Punësimit | HandiKos-<br>Bizneset<br><br>Donatorët | x | x | x | E pa percakt uar |
| 2.3. Informimi dhe orientimi i nxënësve me aftësi të kufizuara të klasave IX-ta për profilizim profesional. | Numri i fëmijëve me AK | Takimet informuese në shkolla. | Informimi sa më i plotë i nxënësve rreth mundësive për përzgjedhje profesionale. | DAK<br><br>SHMP<br><br>HandiKos | Komuna<br><br>Donatorët | x | x | x | Pa kosto |
| 2.4.Stimulimi i PAK-ve për punë praktike në institucionet komunale. | Numri i personave që ndjekin punen praktike. | Numri i personave të cilët kan perfunduar periudhen e punës praktike. | Përfshirja e personave me AK në aftësim profesional në institucionet komunale | Institucionet komunale | HandiKos<br>Donator | x | x | x | Pa kosto |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.5.Përkrahja financiare për PAK në ndjekjen e kurseve të ndryshme në QAP. | Numri i PAK-ve që ndjekin trajnimet së paku 30 PAK. | Lista e atyre që kan përfunduar trajnimet. | Avancimi profesional i komunitetit të PAK. | Komuna | Donatoret | x | x | x | 3780€ |
| 2.6. Ngritja e kapaciteteve të PAK në kompanitë private(Trajnime në punë). | Numri i PAK të aftësuar për profesione të caktuara.(se paku 15 persona). | Numri i PAK të involvuar. | Ngritja e potencialeve të PAK për punësim në sektorin privat. | HandiKos<br>Bizneset | Komuna<br>Donatorët<br>Zyra e Punësimit | x | x | x | 6750€ |

## ARSIMI

*Objektiva Strategjike 4:* Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.

*Objektiva specifike 1: Hartimi i politikave për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit sipas parimeve të gjithë përfshirjes*

| Aktiviteti | Treguesit | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucioni mbështetës | Afati Kohor V 1 | V 2 | V 3 | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1 Të bëhet analiza për gjendjen aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara(me kufizime fizike, në të parë, në të dëgjuar dhe intelektuale). | 1.Raporti mbi analizën e gjendjes aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara.<br>2. Krijimi i bazës së të dhenave për femijët me aftesi te kufizuara të grupmoshave 3-5 vjeç. | Raporti i publikuar. | Të kemi raport dhe të dhëna të besueshme mbi gjendjen aktuale. | DAK<br>HandiKos | Komuna<br>Donatorët | x | | | Pa kosto |
| 1.2. Zhvillimi i fushatave vetëdijësuse për identifikim të hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara. | Numri i fushatave të zhvilluara për identifikim. | Raportet mbi organizimin e fushatave vetëdijësuese. | Njohja e publikut për identifikim të hershëm. | DAK<br>HandiKos | OJQ<br>Donatorët | x | x | x | 500€ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3. Trajnime për prindër për identifikim dhe intervenim të hershëm. | Numri i trajnimeve të mbajtura. | Raportet mbi mbajtjen e trajnimeve. | Prindërit të jenë të përgatitur për intervenim të hershëm. | DAK | HandiKos Institucionet parashkollore | x | x | x | 500€ |
| 1.4. Edukimi jo formal per pregaditjen e femijeve me aftësi të kufizuara. | Organizimi i mesimit jo formal. | Numeri i femijeve te perfshire ne edukim jo formal. | Perfshirja e femijeve me aftesi te kufizuara ne sisitemin arsimor. | DA K | HandiKos<br>Donatorë | x | x | x | 500€ |
| 1.5. Fuqizimi i ekipeve vlerësuese për nevojat e fëmijëve me AK në arsim. | Numri i zyrtarëve komunal të trajnuar. | Baza e të dhënave për trajnimet e mbajtura. | DAK të ketë zyrtarë të trajnuar të ekipeve për vlerësim. | DAK | MASHT | x | x | x | 1500€ |
| 1.6. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve parashkollore për punën me fëmij me AK. | Organizimi i trajnimeve për edukatorët. | Numri i edukatoreve të trajnuar. | Staf i trajnuar për mbështetjen e fëmijëve më aftësi të kufizuara. | DAK | MASHT, HandiKos | x | x | x | E pa percakt uar |
| 1.7. Sigurimi i mesimedhensve dhe asistentëve per femij me aftësi të kufizuara. | Numri i assiteneve dhe mesimdhenesve mbeshtetes. | Asistenetet/m esimedhenesit e punesuar. | Ngritja e cilesis së mesimnxenjes së femijve me aftësi te kufizuara. | DAK | | x | x | x | E pa percakt uar |
| 1.8. Sigurimi i instruktorëve të gjuhës së shenjave dhe alfabetit të Brajlit për fëmijët me kufizime në të dëgjuar dhe në të parë. | Numri i instruktorëve dhe asistentëve të gjuhës së shenjave. | Përshkrimi i vendeve të punës dhe lista e pagave. | Të kemi instruktor dhe asistent të gjuhës së shenjave të punësuar. | DAK<br>MASHT | HandiKos | x | x | x | E pa percakt uar |
| 1.8 Shënimi i datave ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të femijeve me AK. | Numri i aktiviteteve të mbajtura. | Raportet e realizimit dhe numri i pjesmarrësve. | Ngritja e vetëdijes për PAK dhe promovimi i të drejtave të tyre. | DAK<br>Handikos | Donatorët | x | x | x | 1500€ |
| 1.9 Pikë shtesë për studentët me aftësi të kufizuara. | Ndryshimi i Rregullores për ndarjen e bursave. | Numri i perfituesive/studentëve me aftësi të kufizuara. | Përmirësimi i kushteve të studenteve nga kategoria e Personave me Aftësi të Kufizuara. | DAK | Komuna | x | x | x | E pa percakt uar |

**Objektivi specifik** *2: Sigurimi i qasjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në nivelin parafillor,fillor dhe të mesëm të Arsimit*

| Aktiviteti | Treguesit | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucioni mbështetës | Afati Kohor V 1 | V 2 | V 3 | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1 Planifikimi dhe ndarja e buxhetit për arsimin gjithpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara. | Buxheti i planifikuar në nivel të komunës. | Plani buxhetor. | Planifikimi i buxhetit për fëmijë me aftësi të kufizuara në nivel komunal. | DAK<br>DFEZH | HandiKos<br>Donatorët | x | x | x | E papërc aktuar |
| 2.2 Paisja e shkollave me mjete të nevojshme didaktike,teknologjike dhe ndihmëse për fëmijë me aftësi të kufizuara. | Numri i shkollave të paisura me mjete didaktike dhe teknologjike. | Paisjet në shkolla. | Shkollat të jenë të paisuara me mjete të përshtatshme për fëmijë me aftësi të kufizuara. | DAK<br>Shkollat fillore dhe të mesme, Institucionet parashkollore. | Donatorët<br>HandiKos<br>Bizneset | x | x | x | E papërc aktuar |
| 2.3 Sigurimi i transportit të sigurt dhe efikas në të gjitha nivelet për fëmijë me aftësi të kufizuara. | 1.Sigurimi i automjetit special për fëmijë me AK.<br>2.Numri i fëmijëve që u sigurohet transporti i sigurt dhe efikas. | Kontratat me kompanit transportuese ose kontratat me persona fizik. | Komuna të ofroj transport të sigurt dhe falas për fëmijë me aftësi të kufizuara. | DAK | HandiKos | x | x | x | E papërc aktuar |
| 2.4.Sigurimi i komunikimit cilësor në gjuhën e shenjave dhe shkrimit në Brajl dhe të formave të tjera alternative teknologjike për fëmijë me aftësi të kufizuara. | Numri i shkollave që sigurojnë komunikim në shkrimine Brajlit .Numri i shkollave që ofrojnë shërbim në gjuhën e shenjave.Numri i fëmijëve në shkolla që përdorin shkrimin e Brajlit dhe gjuhën e shenjave. | Aplikimi i programit për zbatimin e gjuhës së shenjave dhe alfabetit të Brajlit. | Fëmijëve me aftësi të kufizuara të iu ofrohet komunikimi në gjuhën e shenjave dhe në shkrimin e Brajlit. | MASHT<br>DAK | HandiKos<br>OJQ të tjera<br>Donatorët | x | x | x | E papërc aktuar |

## Qasja,Informimi,Komunikimi dhe Statistika

**Objektiva Strategjike 5**: *Krijimi i kushteve të barabarta në qasje,informim ,komunikim,pjesëmarrje si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar të të dhënave për Persona me Aftësi të Kufizuara.*

| ***Objektivi specifik 1**: Hulumtimi dhe përmirësimi i qasjes në institucione publike dhe private për Persona me Aftësi të Kufizuara në komunën e Kaçanikut* | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Treguesit** | **Mjetet e verifikimit** | **Synimi** | **Institucioni zbatues** | **Institucioni mbështetës** | **Afati Kohor** | | | **Buxheti** |
| | | | | | | **V 1** | **V 2** | **V 3** | |
| 1.1. Hulumtimi për qasje të përshtatshme në institucione publike dhe private për PAK. | 1.Numri i objekteve publike dhe private që i plotesojnë standartet e nevojave të PAK.<br>2.Numri i objekteve që nuk i plotësojnë standartet e qasjes së PAK.<br>3.Numri i objekteve që nuk kan fare qasje fizike për PAK. | Raporti i publikuar i hulumtimit mbi qasjen fizike të objekteve. | Përmirësimi i gjendjes aktuale të qasjes në objektet publike dhe pivate. | DUKM | Donator HandiKos | x | x | x | 500€ |
| 1.2Fushata vetëdijësuese për rëndësinë e qasjes së PAK. | 1.Numri i fushatave vetëdijësuese.<br>2.Fletpalosje/broshura | 1.Numri i fushatave të realizuara<br>2.Numri i fletpalosjeve të shperndara | Ngritja e vetëdijes në lidhje me qasjen në jetën sociale për PAK. | Komuna Handikos | Donatorët | x | x | x | 800€ |
| 1.3.Ndërtimi dhe funksionalizimi i pjerrinave,tualeteve dhe interierit brenda objekteve publike për qasje sipas standardeve për Persona me Aftësi të Kufizuara. | Të identifikohen institucionet ku duhet të ndërtohet apo intervenohet qasja për Persona me Aftësi të Kufizuara. | Krijimi i një harte të strukturave me qasje fizike. | Krijimi i mundësive për qasje në të gjitha institucionet publike dhe private. | DUKM | HandiKos Donatorët<br>. | x | x | x | E papërca ktuar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.Rregullimi/Shenjëzimi i parkingjeve pranë çdo vendkalimi për këmbësor në Bulevardin "Ismail Raka". | Identifikimi i vendkalimeve dhe nevoja e parkingjeve për PAK. | Shenjëzimi i parkingjeve. | Përmirësimi i qasjes për PAK. | DSHPEC | HandiKos Donatorët | x | | | E papërca ktuar |

*Objektivi specifik 2:Krijimi i mundësive për përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në jetën kulturore dhe transportin publik*

| Aktiviteti | Treguesit | Mjetet e verifikimit | Synimi | Institucioni zbatues | Institucioni mbështetës | Afati Kohor V 1 | V 2 | V 3 | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.Përfshirja e PAK-ve në aktivitete sportive dhe kulturore. | 1.Hartimi i politikave dhe kalendareve kohore për përfshirjën e PAK në aktivitetet rinore.<br>2.Hartimi i politikave dhe kalendareve kohore për përfshirjën e PAK në aktivitetet sportive.<br>3.Hartimi i politikave dhe kalendareve kohore për përfshirjën e PAK aktivitetet artistike. | Dokumentet e hartuara. | Përfshirja e çështjës së PAK-ve në jetën kulturore si dhe socializimi i tyre me këto aktivitete. | DAK | HandiKos Donatorë | x | x | x | 3000€ |
| 2.2.Mbështetja financiare e projekteve nga aktivitetet kulturore – artistike dhe sportive për PAK. | 1.Projektet e përkrahura nga institucionet.<br>2.Buxheti i ndarë për projektet e PAK. | Raporti lidhur me numrin e projekteve që janë përkrahur dhe buxheti i ndarë për PAK. | Përmirësimi dhe ndarja e buxhetit për PAK në kulturë,rini dhe sport. | DAK DFEZH | HandiKos | x | x | x | E papërca ktuar |
| 2.3.Përfshirja e të rinjëve me Aftësi të Kufizuara në aktivitetet rinore. | 1.Numri i të rinjëve në aktivitete si kampe verore,gara me karroca, pingpong, shah, mini olimpiada etj.<br>2.Përfshirja e të rinjëve nga PAK në aktivitetet e Javës së Rinisë. | Raporti lidhur me përfshirjen e të rinjëve me AK në aktivitetet rinore. | Përfshirja e numrit më të madh të të rinjëve me AK në aktivitetet rinore. | DAK | HandiKos | x | x | x | Pa kosto |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.Përshtatshmëria e infrastrukturës në stacionet e transportit Publik. | Pasqyrimi i gjendjes aktuale. | Numri i stacioneve të transportit publik,përfshirë vend-ndaljet. | Përmirësimi i infrastrukturës në transportin publik. | DSHPEC | HandiKos Donatorët | x | x | x | E papërca ktuar |
| 2.5.Paisja e mjeteve të transportit publik me pjerrina,sinjale tonike dhe vizuale. | Numri i mjeteve të transportit publik të paisura me pjerrina,sinjale tonike dhe vizuele. | Raporti nga mjetet e transportit publik. | Paisja e mjeteve të transportit publik me mjetet e nevojshme për Personat me Aftësi të Kufizuara. | DSHPEC | HandiKos Kompanitë private. | x | x | x | E papërca ktuar |

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).